



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 31.01.2020,
duke filluar në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Eman Rahmani, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, dhe Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Fatos Dibra propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës **"Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës"**.

Jeta Rafuna propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës **"Propozimi për vendosjen e shtatores së Anton Çetës"**.

Fatos Dibra bëri të ditur se nuk ka material të gatshëm, andaj mbetet të shihet se a mund ta përgatisim materialin për mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi theksoi se do ta shqyrtojmë këtë çështje bashkë me nënkyetarin dhe nëse është i gatshëm materiali, do ta përfshijmë në rendin e ditës në mbledhjen e Kuvendit.

Eman Rahmani propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës **"Diskutim për votimin që dita e diel të jetë ditë pushimi në komunën e Prishtinës"**.

Kryesuesi theksoi se për t'u bërë një gjë e tillë duhet hartuar rregullore.

Fatos Dibra theksoi se është një procedurë ligjore për ndryshimin e rregullores. Nëse bëjmë ndryshime në rregullore, është mirë të kthehet prapë në diskutim publik kjo çështja që po e propozoni.

Faqe 1 nga 7

Halim Halimi sugjeroi që të fillohet me procedurat për ndryshimin e Rregullores dhe kur të jetë e gatshme të sillet në Kuvend.

Eman Rahmani propozoi që të futet si temë diskutimi në Kuvendin e Komunës, deri atëherë ndoshta mund ta përgatitni për ta sqaruar, e shikojmë në cilën fazë jemi dhe nëse mund ta ndryshojmë aty për aty do të ishte mirë, nëse nuk mundemi, atëherë e qesim në diskutim publikë dhe vjen prapë në Kuvend.

Fatos Dibra tha se nuk e di prej ekzekutivit a është e gatshme edhe ajo që është bërë.

Kryesuesi theksoi se për këto dy propozimet, për Anton Çetën dhe Rregulloren për veprimtari afariste, për të dielën ditë pushimi, mbetet unë të bisedoj me kryetarin e Komunës.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, me propozimin që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2019 (TM4);
3. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Naxhije (Rashit) Herticës, Bahrije Pakashticës dhe Mustafa Pakashticës;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zuka (Isuf) Bekës;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanicës, Ismit (Avdi) Shabanit, Sabit (Avdi) Shabanit, Adem (Shaban) Berishës dhe Sylejmon (Sadik) Topanicës;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës;
11. Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës;
12. Propozimvendimi për autorizim të borxhit;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Komitet për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë dhe e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2019, (TM 4).

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019.

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2019, (TM 4), dhe Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019, dha sqarime në pika të shkurtra **Valbona Ahmeti - Makolli**, drejtoreshë e Financave. Ajo tha se të hyrat për vitin 2019 janë realizuar në një përqindje 99.05%. Buxheti i përgjithshëm i viti 2019 është realizuar në përqindje 70.80%. Buxheti për të gjitha kategoritë ekonomike për vitin 2019, është planifikuar në vlerë prej: 111,076,634.24 €. Nga këto mjete për paga dhe mëditje janë shpenzuar 94.65 %, për mallra dhe shërbime 86.53%, për shërbime komunale 95.99%, për subvencione dhe transfere 92.04 %, dhe për investime kapitale 40.94 %. Po ashtu, ceku se për subvencionet i kanë qitur në raporte adresat se ku mund të kyçeni për t'i parë detajet një nga një, përvèç Drejtorisë së Arsimit, e cila nuk i ka të publikuara, dhe kemi kërkuar që në vitin 2020 t'i publikojnë edhe ata.

Te lista e kontratave të nënshkruara, që janë bërë prej anës së Prokurimit, i kemi nxjerrë projektet, të cilat janë nënshkruar prej 1 janarit deri më 31 dhjetor, ku Komuna e Prishtinës i ka pasur gjithsej 272 projekte me prokurim, për 167 prej tyre janë nënshkruar kontratat deri në fund të shtatorit. Është me rëndësi të ceket se nga 105 projekte të kësaj liste, shumica prej tyre janë nënshkruar tre muajt e fundit, ku një pjesë e konsiderueshme nuk kanë pasur as implementim financiar.

Agim Gashi kërkoi sqarime për të dhënat që janë në raport financiar, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019, në faqet 9, 18 dhe 20, ku në të tri faqet pasqyrat financiare nuk përputhen dhe nuk ka sqarime, përmbajtja është e njëjtë por të dhënat nuk përputhen.

Çështje tjetër është te raporti i subvacioneve të Arsimit, ku është lista me shumë emra, të cilët i kanë marrë nga 500 €. A është fjala për bursa? Nëse po, atëherë të ceket se janë bursa.

Po ashtu, sugjeroi që te projektet e mëdha, siç janë: zbatimi i Planit të mobilitetit, ku janë shpenzuar vetëm 10%; te rruga "B" nuk janë shpenzuar, vazhdimi i rrugës "B". Është mirë që për projektet e mëdha të pashpenzuara me qenë një fjalë sqaruese, që do të tregonte se janë bartur, apo janë marrë ato mjete e janë bartur diku tjetër.

Te kodet buxhetore, vlerat e mëdha, siç është ndërtimi i rrugëve urbane ose infrastrukturës urbane dhe rurale, duhet me u specifikuar se cila është lista e projekteve, cilat janë rrugët, kanalizime e tjera, kështu që janë disa çështje që duhet me u prekur dhe me u thënë, ndërsa

ajo që po përcillet prej vitit në vit, është te planifikimi, ku shumë drejtori sipas pasqyrës, po dalin që katër drejtori kanë zero shpenzime të buxhetit, dy drejtori kanë mbi 50% shpenzime dhe gjashtë drejtori kanë nën 50% shpenzime të buxhetit. Kjo na sjell një performancë shumë të ulët te shpenzimet e buxhetit. Pra, duhet të bëhen analiza paraprake për planifikim, se propozimet për ndarjen dhe shpërndarjen e buxhetit sipas drejtorive po bëhen pa analiza paraprake.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime, duke cekur se sa i përket subvencioneve te Arsimi, mund ta bëjë një shpalosje, ndërsa sa i përket projekteve, kam kërkuar prej drejtorëve në Bord, por mundem prapë me iu drejtuar me një e-mail, që secili drejtor me paraqitur raportin e vet për projektet e veta se ku kanë shkuar mjetet. Sa i përket të dhënave në faqet 9, 18 dhe 20, mund t'i kontrollojë edhe një herë.

Agim Gashi parashtrroi pyetje se a ka nga grantet që nuk janë shfrytëzuar dhe nuk janë paraqitur në këtë raport. Nëse nuk ka, atëherë a janë shfrytëzuar 100 % grantet.

Valbona Ahmeti - Makolli u përgjigj, duke thënë se nuk ka, grantet nuk janë që janë shpenzuar, por janë paraqitur, janë mbi 4 milionë që i tërheq Ministria e Financave, janë në raport, nuk janë shpenzuar 100 %.

Halim Halimi theksoi se është hera e parë që në Komunë të Prishtinës humbet granti, vitin e kaluar nuk i kemi pasur, tash kanë humbur mbi 4 milionë, kështu që parashikimet që i kemi thënë ne tash një vit, ato po dalin të sakta. Ne patëm thënë se mbi 35 milionë kanë me i mbetur Komunës së Prishtinës pa shfrytëzuar, kështu që për këtë punë nuk janë të interesuar as ekzekutivi, shumicës së drejtorëve nuk iu intereson për punë, siç e tha edhe Agimi, 3-4 drejtori zero investime, disa më pak se 50% investime, ndërsa dy drejtori mbi 50% investime. Sa i përket të hyrave, paraqitet vizualisht, është realizuar plani 99%, mirëpo ka mundur edhe më shumë, se nuk janë shfrytëzua pagesat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike, parkingjet. Çka është paraparë më së shumti, është arkëtimi për mbledhjen e mbeturinave, 4 milionë e diçka, e jonë vetëm 2 milionë, mirëpo, siç po shihet, puna gjatë vitit 2019 gjithmonë ka shkuar duke rënë. Disa drejtori kanë zero shpenzime, shpenzimet kontingjente gjithmonë po rriten, kontratat për shërbime të veçanta po ashtu po rriten, janë mbi 200 kontrata mbi vepër, kështu që nuk është duke u punuar sa mundë të punohet. Kryetari i Komunës duhet të bëjë një strategji me drejtorë, po ashtu edhe me anëtarë të Kuvendit, në mënyrë që të dilet nga kjo situatë.

Fadil Gashi tha se tash e dy vjet jemi duke diskutuar për drejtorë, ku vetëm drejtoresha e Financave na përgjigjet, e për këtë më së miri flet rezultati i të gjitha drejtorive se sa kanë shpenzuar buxhet. Nëse kryetari nuk bën ndryshime në këto drejtori, nuk merr masa, pritet që të jetë edhe më keq.

Egzon Azemi shprehu mendimin se drejtoresha e Financave do të duhej kërkuar prej drejtorëve te subvencionet, si te Drejtoria e Arsimit, janë disa pika, ku janë shuma të caktuara të ndara për disa persona fizikë dhe nuk kemi shpjegime për çka janë ndarë ato mjete dhe subvencionet që iu bëhen çerdheve, ku vetëm tarifat ndryshojnë, andaj do të duhej të jepnin sqarime drejtorët për këto çështje.

Fatos Dibra dha sqarime lidhur me këtë.

Agim Gashi tha se rregullorja rregullon mënyrën e pagesës, pra është rregullorja, ne e kemi votuar, duhet me u cekur në raport të gjitha procedurat që i referohen rregullores.

Faqe 4 nga 7



Eman Rahmani u shpreh i pajtimit me Fadilin, mirëpo ai kërroi nga shefat e GP-ve që me mbështetur Raportin, me ardhur me prezantuar secili drejtor, e jo vetëm drejtoresha e Financave, dhe të mos fillojë mbledhja nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë.

Agim Gashi tha se jo secili drejtor, referimin e parë duhet ta bëjë Kryetari i Komunës, sepse ky është raport i Kryetarit, pastaj drejtorët janë për me raportua për specifika.

Kryesuesi theksoi se raportimin e bën Kryetari, siç tha Agimi, me ligj parashihet, ndërsa drejtorëve me iu kërkuar sqarime për secilin projekt veç e veç. Në plan të punës parashihet raportimi prej secilës drejtori, për fusha të ndryshme të secilës drejtori, andaj unë po insistoj prej juve me kërkuar me pasur raport, sepse është e paraparë në bazë të planit të punës.

Agim Gashi u shpreh se ju kërkonit të respektohet ligji, nëse respektohet ligji, ata janë të obliguar me qenë. Sipas Ligjit të pushtetit lokal, Kryetari i Komunës është i obliguar me bërë prezantimin për raportet periodike dhe reportin vjetor në Kuvend, e për specifikat jap detale drejtori. Kështu mundet me qenë informata e plotë, e vetëm kështu mundeni me kontribuar.

Kryesuesi tha se mbetet që drejtoresha e Financave me plotësua reportin me rekomandimet e paraqitura.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2019, (TM 4) dhe Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Halim Halimi theksoi se nuk po zbatohet Plani vjetor i punës së Kuvendit. E kemi pasur edhe planin e përparshëm, nuk kemi analizuar, nuk ka raportuar askush, nuk i janë përbajtura këtij plani. Plani duhet hartuar, por edhe duhet përbajtur atij plani.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.

Agim Gashi tha se për planet rregulluese kaherë kemi kërkuar një sqarim adekuat për të lehtësuar çdo gjë, por nuk po na jepet, është mirë adresat me i theksuar se për ku është fjala. Është e rrugës që kur të prezantohen parcelat me numër, mundësishët të jetë edhe adresa,

këshilltarët kanë të drejt me kërkuar, caktoja adresën, sepse në bazë të adresës e gjejnë e kujtështë. Pa adresë nuk ka transparencë.

Sami Boroci tha se kjo çështja e shkëmbimit të pronave ka mbi një vit që e kemi diskutuar, kemi pasur diskutime të ndryshme, po e diskutojmë prapë, e njëjta gjë po vazhdon. E para, unë nuk e di që këto po kalojnë në Komitet të Pronës, unë besoj se do të duhej refuzuar, pa kaluar në Komitet të Pronës mos me ardhur në Kuvend. Do të duhej të vinte drejtori i Pronës me na i sqaruar këto pika.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Naxhije (Rashit) Hertica, Bahrije Pakashtica dhe Mustafa Pakashtica.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Naxhije (Rashit) Hertica, Bahrije Pakashtica dhe Mustafa Pakashtica, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zuka (Isuf) Bekës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zuka (Isuf) Beka, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon (Sadik) Topanica.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon (Sadik) Topanica dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Faik Breznica dhe Osman Breznica.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Faik Breznica dhe Osman Breznica, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për autorizim të borxhit.

Kryesuesi tha se sa i përket pikës "Propozimvendimi për autorizim të borxhit", këtë e kemi votuar një herë, por Ministria ka kërkuar që të bëhen plotësime.

Fatos Dibra dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.

Kryesuesi tha se ideja është kjo, se ky propozimvendim është futur si pikë e rendit të ditës nëse sillet në ndërkohë, mos me humbur kohë për mbledhjen tjeter, nëse jo, atëherë e tërheqim në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për autorizim të borxhit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

Procesmbajtësja
Shyharete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

Faqe 7 nga 7